



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

Koreja e Jugut propozon bisedime për t'i dhënë fund zyrtarisht luftës me Korenë e Veriut
- 2

'Territorialja'/ Me këngë e valle të zonës, banorët e Divjakës vijnë të kundërshtojnë bashkimin me Lushnjën (VIDEO)
- 3

U largua pas 10 vitesh, tifozët e Atalanta-s ndërojnë Berat Gjimeshtin: Mbetesh një bergamask i vërtetë
- 4

Si i përgjoi Berisha armiqte dhe bashkëpunëtorët e tij për 30 vite, nga Azem Hajdari e Serreqi tek Lulzim Basha, dëgjoi mbi 800 biseda të Metës (fakte e dëshmi)
- 5

Shembet dhe del jashtë shtrattit kanali vaditës, hapet pas disa orësh qarkullimi në rrugën Elbasan-Cërrik

Kronikë

Me pistoletë në makinë, pranga 2 të rinjve në Fier! Kërcënoi me armë, arrestohet një tjetër në Mallakastër (VIDEO)

Tre persona janë arrestuar në Fier pasi u konstatuan me armë për arsye të ndryshme.

Fier/Me pistoletë në mjet, pranga 2 të rinjve!Kërcënoi me armë, arrest

Report TV



Watch on

Redaksia 15 Gusht, 13:29 | Përditësimi: 15 Gusht, 13:42

Share Post



Tre persona janë arrestuar në [Fier](#) pasi u konstatuan me armë për arsye të ndryshme. Në pranga ka rënë një 19-vjeçar, [Miklejin Monce](#), të cilit i është gjetur një pistoletë në makinë, si dhe shoku i tij, 28 vjeç. Pasagjeri [Flavio Bregu](#) arrestua pasi kishte dijeni se arma e zjarrit do të shitej në Fier.

Në Mallakastër, 38-vjeçari [Ilir Sinaj](#) u arrestua pasi kërcënoi me armë gjahu një person tjetër. Në banesë iu gjet edhe një kallashnikov.

Njoftimi i policisë:



LEXO EDHE:
'Territorialja'/ Me këngë e valle të zonës, banorët e Divjakës vijnë të kundërshtojnë bashkimin me Lushnjën (VIDEO)

Brenda 24 orëve, finalizohen 2 operacione policore në Fier dhe Mallakastër. Sekuestrohen 2 [armë zjarri](#) dhe 1 armë gjahu. Vihen në pranga 3 shtetas.

Në vijim të kontrolleve të intensifikuara për evidentimin dhe goditjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Fier, në bashkëpunim me Sektorin për Hetimin e Narkotikëve dhe me mbështetjen e shërbimeve të Forcës së Posaçme "Shqiponja" dhe Forcës së Posaçme Operacionale, bazuar në informacionet e siguruaruara në rrugë operative se një shtetas lëvizte i armatosur me armë zjarri në automjet, finalizuan operacionin policor të koduar "Aksi".

Në kuadër të këtij operacioni, në Bypass-in e Fierit u kap dhe u vu në pranga shtetasi M. M., 19 vjeç, banues në Vlorë. Gjatë kontrollit të automjetit që drejtonte 19-vjeçari, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri, tip pistoletë.

Në vijim të veprimeve procedurale, u arrestua edhe shtetasi F. B., 28 vjeç, banues në Vlorë, pasagjer në automjet, pasi dyshohet se kishte dijeni se shoku i tij, shtetasi M. M., posedonte armën e zjarrit dhe do ta shiste në Fier.

Ndërkohë, në Mallakastër, u finalizua operacioni policor i koduar "Hidden Guns", në kuadër të të cilit u arrestua në flagrancë shtetasi I. S., 38 vjeç, banues në fshatin Lofkënd, Mallakastër.

Ky shtetas dyshohet se, pas një konflikti për motive të dobëta, ka kanosur me armë gjahu një shtetas tjetër. Ndërhyrja e menjëhershme e shërbimeve të Policisë bëri të mundur neutralizimin e situatës, arrestimin e autorit të dyshuar dhe sekuestrimin e një arme zjarri, tip kallashnikov, dhe një arme gjahu, të cilat i kishte fshehur në banesë dhe i mbante pa leje.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprime të mëtejshme.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.

P.J/E.H/Shqiptarja.com

TAG: Ilir Sinaj Miklejin Monce Flavio Bregu arme zjarri arrestim Fier

Sa e vlerësoni këtë artikull?



LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohe rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës: Cili është shkaku i konflikteve në Shqipëri?

15 Gusht, 13:45

Politika Shoqëria Social media

Lajme të tjera



Manastiri i Apolonisë grumbullon besimtarët për Fjetjen e Shën Mërisë, Imzot Nikolla: Nuk jemi vetëm në sfidat tona

15 Gusht, 14:19



Dhuno i kumatën, nipi e kërcënon me armë! Arrestohet xhaxhai, në kërkim 19-vjeçari, 3 nën hetim

15 Gusht, 11:22



Transportonin armë zjarri nga Kosova, 2 në pranga në Maminas! Sekuestrohen 3 pistoleta

15 Gusht, 10:48



S'iu bindën policisë dhe 'fluturuan' me makinë, arratia e çmendur e dy të rinjve shqiptarë në Itali rrezikon pushuesit

14 Gusht, 16:55



Tejkalim shpejtësie dhe parakalime të gabuara, Rrugorja e Fierit me 'dorë të hekurt': Një mijë gjoba në një javë (VIDEO)

14 Gusht, 13:36



'Territorialja', këshilli bashkiak i Divjakës kundërshton shkrijen me Lushnjen (VIDEO)

14 Gusht, 13:11



Ndarja e re territoriale/ Selenica e Divjaka i thonë 'jo' shkrijes së bashkive, këshillat kundër draftit të PS! Në Rrogozhinë protestë kundër bashkimit me Kavajën

Armand Xhelili



Yrjet Saliasi

14 Gusht, 12:50



'I kamufluar' si menaxher lokal, pranga furnitorit dhe shpërndarësit të kokainës në Tiranë! Prej 2 muajsh nën 'radarin' e Antidrogës, kërkoni 8500 € për 250 gramë (VIDEO)

14 Gusht, 11:00



U zunë për pronën dhe kërcënoi vëllanë me pistoletë, arrestohet 47-vjeçari në Vlorë (EMRI+VIDEO)

14 Gusht, 09:12



Zjarret/ Lura në flakë, digjen 300 hektarë pyje! Riaktivizohet vatra në Zidoll të Krujës, zjarrfikësit në terren për normalizimin e situatës

14 Gusht, 09:04




Ura pa barriera mbrojtëse, makina bie në kanal! Vdesin në aksident tragjik 2 motra në Lushnjë, u mbytën në ujë (VIDEO)

13 Gusht, 20:28



Fier/ Përfshihet nga flakë masiv pyjor i Peshtanit, zjarri larg zonave të banuara (VIDEO)


13 Gusht, 20:11



Koreja e Jugut propozon bisedime për t'i dhënë fund zyrtarisht luftës me Korenë e Veriut

15 Gusht, 22:44





× **[Sh]**
.com Lajmi i fundit



**Koreja e Jugut propozon bisedime
për t'i dhënë fund zyrtarisht luftës
me Korenë e Veriut**

15 Gusht, 22:44